

PROCESVERBAL
nga seanca e 6-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatika Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 11.02.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë përmes lidhjes video-konferencë:
Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: Lazar Trajçev.

Në seancë përmes lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishmit nga Shërbimi Profesional përmes lidhjes video-konferencë:
Mr.Dragica Ljubevska, mr. Magdalena Davidovska Dogleva, Nesrin Sejfulla, mr. Biljana Boshnakoski, mr. Tanja Lazoroska, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski, hapi seancën e 6-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 19:40 dhe u mbajt përmes lidhjes video-konferencë.

Z. Petrushevski shpjegoi se në seancë do të mungojë z.Trajçev, i cili për shkak të qëndrimit jashtë vendit, mungesën e tij e paralajmëroi në seancën e kaluar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 5-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 10.02.2025.
2. Propozim-vendim për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR TV MTM SHPKNJP nga Shkupi.
3. Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar dhe Listave të regjistrimit nga regjistrimi i kryer në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024.
4. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoj dhe njëzëri miratoj Procesverbalin e propozuar të seancës së 5-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 10.02.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z.Trajçevski ka shpjeguar Propozim-vendimin për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR TV MTM SHPKNJP nga Shkupi. Ai shpjegoi se pronari aktual i televizionit nuk ka mundësi të paguajë kompensimin vjetor të lejes dhe duke qenë se ka një pronar të ri potencial për të paguar kompensimin, është kërkuar ndryshimi i strukturës së pronësisë. Nëse nuk paguhet kompensimi vjetor duhet të vijon iniciimi i procedurës për heqjen e lejes të këtij transmetuesi. Ai informoi se gjatë ditës së djeshme ka pasur një takim me udhëheqësen Magdalena D.Dovleva lidhur me temën nëse ka bazë juridike për të mundësuar ndryshimin e strukturës së pronësisë. Pas kontrollit në Regjistrin Qendror, është konstatuar se pronari i ri potencial është kryetar i Federatës së Hokejit të Maqedonië dhe figuron si ortak në Shoqërinë për tregti dhe shërbime CVETNA AKADEMIJA SHPKNJP Shkup. Pra, nuk shkelen dispozitat e LSHMAAV, përkatësisht nuk krijohet përqendrim i paligjshëm mediatik.

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva, shpjegoi se njoftimi është i rregullt dhe i plotë dhe i përmban të gjitha të dhënat në përputhje me Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë. Është kërkuar që të dal pronari aktual personi fizik Gordana Andreevska, dhe qasje të personit fizik Nikolla Tasev. Janë dorëzuar të gjitha deklaratat e nevojshme të noterizuara, me të cilat nuk shkelen dispozitat nga Kapitulli 4 i LSHMAAV dhe plotësuese është kryer dhe kontroll në Regjistrin Qendror dhe është konstatuar se personi fizik që është planifikuar të jetë themelues i televizionit, paraqitet si personi i autorizuar i Federatës së Hokejit të Maqedonisë dhe Shoqërisë për tregti dhe shërbime Cvetna Akademija. Kjo do të thotë se nuk ka asnjë pengesë sa i përket LSHMAAV, që ky person të paraqitet si pronar i transmetuesit, dhe për këtë arsye i propozohet Këshillit që të miraton ndryshimin e strukturës së pronësisë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim me të cilin lejon ndryshim në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV MTM SHPKNJP Shkup.

Me ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV MTM SHPKNJP Shkup, nuk krijohet koncentrim i paligjshëm mediatik në kuptimin e LSHMAAV, përkatësisht ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 nga Ligji i njëjtë.

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV MTM SHPKNJP Shkup, detyrohet që të zbaton ndryshim në strukturën e pronësisë në Regjistrin Qendror të RMV-së, në afat prej 3 (tre) muajsh nga dita e pranimit të Vendimit, në të kundërtën, pas skadimit të afatit të përcaktuar, Vendimi nuk do të ketë ndikim juridik.

Sektorit për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 3

Anëtarja e Komisionit për regjistrim Nesrin Sejfulla ka shpjeguar Propozim-vendimin për miratimin e Raportit përfundimtar dhe Listave të regjistrimit nga regjistrimi i kryer në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024. Ajo shpjegoi se mr.Biljana Boshnakoski, e cila ishte kryetare e Komisionit për regjistrim aktualisht është në pushim mjekësor dhe për këtë arsye do ta prezantojë Raportin përfundimtar. Ajo tha se Komisioni është formuar me Aktvendimin nr.03-5150/1 datë 17.12.2024, që detyrohet deri më datë 31.12.2024, të kryen regjistrimin e objekteve, pajisjeve, materialit harxhues, inventarit të imët dhe kërkesave dhe detyrimeve të Agjencisë për vitin 2024. Gjatë realizimit Komisioni për regjistrim i është përmbytur dispozitave të Ligjit për kontabilitet të organizatave jofitimprurëse dhe Udhëzimit për kryerjen e regjistrimit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.01-4486/1 datë 10.12.2021. Në përputhje me Udhëzimin për kryerjen e regjistrimit(inventarit) të ASHMA-së, Komisioni për Regjistrim me datë 18.12.2024 hartoj një Plan pune për regjistrimin e vitit 2024, i cili përcaktoi kalendarin për çregjistrimin e stoqeve në magazinë, mjetet financiare dhe gjendjen e llogarive bankare të Agjencisë, të kërkesave nga blerësit dhe detyrimet ndaj furnitorëve dhe për mjetet, inventar të imët dhe veglat në përdorim të mbajtësve të vlerave materiale të renditura në vendin e punës sipas Rregullores për sistematizimin e vendit të punës së Agjencisë. Ajo theksoi se Komisioni për regjistrim ka përcaktuar: Azhurimin e rregullt dhe vënien në listat me numra inventari si dhe shenja të tjera të parashikuara gjatë pranimit të pajisjeve të reja, se artikuj të caktuar nuk kanë të shënuar numër inventar të evidentuar, se disa inventar të vjetër dhe shenja të tjera përputhen (gjatë kryerjes së këtij regjistrimi, Komisioni ka konstatuar raste ku numri i inventarit përsëritet, prandaj dhe këtë vit regjistrimi Komisioni i njoftoi të punësuarit për punën materiale të Sektorit për financa dhe logjistikë. Kjo është konstatuar dhe nga komisioni i emëruar për regjistrim në vitin 2023). Në përputhje me këtë Komisioni për regjistrim propozon: emërimin e një personi të punësuar në Agjenci, i cili do të jetë përgjegjës për evidencën udhëheqjen e pajisjeve bazë dhe pajisjeve gjatë vitit kalendarik, në veçanti evidencë përkatëse dhe në kohë të pajisjeve të reja, shënimin e tyre përkatës dhe vënien në listën e pajisjeve bazë dhe funksionin e mëtejshëm, azhurimin e rregullt në softuerin e punës materiale-financiare me numrat e inventarit gjatë hyrjes të pajisjeve bazë në Agjencion, shënimin e mjeteve që nuk janë në pronësi të Agjencisë (printer/skener), me qëllim që komisioni më lehtë të përcakton për çfarë mjeti bazë bëhet fjalë, mjetet që janë çregjistruar, por që ende gjenden në hapësirat e Agjencisë, të hiqen nga objekti, në përputhje me dispozitat ligjore pozitive ose të shënohen qartë me etiketa të kuqe, që nuk janë më objekt të regjistrimit të ardhshëm, detyrohet Sektori për çështje juridike dhe prokurim publik të harton propozime me propozim-vendime për fshirjen e borxhit të nëntë komitentëve, në përputhje me propozimin e dorëzuar nga Sektori për financa dhe logjistikë, që janë specifikuar në pikën 11 të këtij Raporti përfundimtar. Gjatë fshirjes, numërimit dhe kontrollit, Komisioni për regjistrim ka përcaktuar ndryshimet në vijim ndërmjet gjendjes kontabël dhe gjendjes së përcaktuar nga regjistrimi se: gjashtë telefona zyrtar nuk janë gjëndur në hapësirat e Agjencisë dhe janë propozuar për çregjistrim nga Sektori për mbështetje informatike dhe çështje të përgjithëshme, për dy telefona celular komisioni i regjistrimit posedon dokumentacion e cila ju është dorëzuar si shtojcë të këtij materiali, gjithashtu, për objektin fregorifer i kombinuar posedojmë dokumentacion, përkatësisht i njëjtë është dhënë si mbeturin mjet i lëvizshëm nga Agjencia, për pjesët që mungojnë nën numrin rendor 9, 10 dhe 11 nuk janë gjetur në Agjencion, prandaj propozohet që të çregjistrohen.

Z. Petrushevski tha se Këshilli në materialet i ka listat e regjistrimit dhe të gjitha dokumentet e tjera që është një material voluminoz i pranuar para disa ditëve. Ai shpjegoi se

Këshilli i Agjencisë për këtë pikë votoi për dhënien e miratimit, që drejtori të marrë vendim për Raportin përfundimtar dhe për Listat e regjistrimit, dhe vendime për të kryer çregjistrim, të gjitha këto vendime i merr drejtori me propozim të komisionit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Drejtorin e Agjencisë që të marrë Vendim për miratimin e Raportit përfundimtar ark.nr. 01-523/1 од 03.02.2025, për regjistrimin e kryer të objekteve, pajisjeve, materialeve harxhuese, inventar i imët, kërkesave dhe detyrimeve të Agjencisë për vitin 2024 dhe Listave të regjistrimit nga regjistrimi i kryer në Agjenci, për vitin 2024, të cilat dorëzohen si shtojcë e Raportit përfundimtar, përkatësisht:

- Listë regjistrimi për stoqet e materialeve në magazinë, e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojcë nr.3;
- Listë regjistrimi për mjetet në denarë dhe valutë, e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojcë nr.4;
- Listë regjistrimi e mjeteve bazë (pajisje dhe inventar), e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojcë nr.5;
- Listë regjistrimi e gjendjes së konstatuar të ekzistencës së mjeteve të subjekteve të tjera (mjete të huaja), e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojcë nr.6;
- Listë regjistrimi për mjetet bazë që nuk ndodhen në ndërtesën e Agjencisë, e cila ëi bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojcë nr.7;
- Listë regjistrimi me propozim për çregjistrim/shpenzim të inventarit dhe pejisjeve, e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojcë nr.8;
- Listë regjistrimi të kërkesave dhe detyrimeve, e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojcë nr.9 dhe
- Listë regjistrimi i inventarit të imët, e cial i bashkëngjitet Raportit përfundimtar si Shtojcë nr.10.

Në pajtim me Vendimin në fjalë, të kryhet çregjistrim të mjeteve bazë, që përfshin Lista e regjistrimit me propozim për çregjistrim/shpenzime inventari dhe pajisje, e cila i bashkëngjitet Raportit përfundimtar (si Shtojcë nr.8), përcaktuar në pikën 1, nënparagrafi 6 të Vendimit.

Mjete e fshira bien në ngarkesë të kapitalit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Pika 4

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**